

VENDIM
Nr.209, datë 25.2.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA ZGJERIMI I STADIUMIT, NË
BASHKINË E RROGOZHINËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i stadiumit, në bashkinë e Rrogozhinës, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Masa e shpërblimit të pronarit të pasurisë, pronë private, me sipërfaqe 80 (tetëdhjetë) m², tokë/arë, dhe 40 (dyzet) m² ndërtesë, që shpronësohet, është 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë.

3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Rrogozhinës, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Rrogozhinës.

6. Afati i përfundimit të punimeve, në objektin “Zgjerimi i stadiumit” të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki, për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Rrogozhinës. Regjistrimi i ri i pasurisë, 80 (tetëdhjetë) m², tokë/arë, dhe 40 (dyzet) m², ndërtesë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Rrogozhinës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E STADIUMIT TË RROGOZHINËS, NË BASHKINË
RROGOZHINË**

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja në m ² truall	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Pasuria nr.	Zona kadastrale
1	Rifat Toska	80	2500	200.000	323	3234
Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja në m ² ndërtesë	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Pasuria nr.	Zona kadastrale
1.	Rifat Toska	40	40.000	1 600 000	288	3234

	Vlera totale			1 800 000		
--	--------------	--	--	-----------	--	--